VENDIM
Nr.7, datë 6.1.1997

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË HARTIMIT TË PROJEKTIT PËR VLERËSIMIN E NIVELIT AKTUAL TË NDOTJES SË RAJONIT TË LUMIT FAN NGA VEPRIMTARIA E INDUSTRISË SË BAKRIT DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR REHABILITIMIN DHE FINANCIMIN E TIJ ME FONDE GRANT NGA QEVERIA SUEDEZE

Me propozimin e Ministrisë të Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të hartimit të projektit për vlerësimin e nivelit aktual të ndotjes së rajonit të lumit Fan nga veprimtaria e industrisë së bakrit dhe masat që duhen marrë për rehabilitimin dhe financimin e tij me fonde grant nga Qeveria suedeze për shumën 4 190 000. 0 korona suedeze.

2. Për zbatimin e projektit ngarkohen Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit.

3. Autorizohet Ministri i Burimeve Minerare dhe Energjetike, ose një person i autorizuar prej tij, të firmosë marrëveshjen me firmën konsulente.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi